



**PRISHTINA
PRIDE 2025**

**JAVA E
KRENARISË**

AGJENDA
9-14 Qershor

"Asnjë Hap Mbrapa"

Java e Krenarisë // 9 - 14 Qershor 2025

Edicioni i nëntë i Javës së Krenarisë në Kosovë është këtu!

"Asnjë Hap Mbrapa" përfaqëson angazhimin tonë për të qëndruar të fortë kundër lëvizjeve lokale e globale që po përpiqen të minojnë të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe dinjitetin themelor të të gjithë individëve pa dallim. Përballë rritjes së urrejtjes, diskriminimit dhe përpjekjeve për të fshirë identitetet tona, ne nuk do të tërhiqemi. Ne nuk do të heshtim. Ne nuk do të fshihemi. Kjo Javë e Krenarisë është një rikujtim se ne, personat LGBTQI+ në Kosovë, kemi bërë rezistencë dhe arritje të mëdha, dhe pavarësisht pengesave që hasim, përparimi ynë nuk do të kthehet mbrapsht.

Rezistenca jonë është e fuqizuar nga uniteti, dhe ne ecim përpara, së bashku, me vendosmërinë që "Asnjë Hap Mbrapa" është po aq për mbrojtjen e pozitës tonë, sa është për refuzimin për të lejuar dikë që të na kthejë në hije. Tema e këtij viti lind nga diskursi aktual lokal dhe global, ku kundërshtimi ndaj të drejtave të personave LGBTQI+ dhe drejtësisë gjinore kërcënon vetë progresim për të cilin kemi luftuar për ta arritur. Ajo mishëron premtimin tonë për të qëndruar të fortë/a përballë këtyre kërcënimeve—jeta jonë nuk është e negociueshme. Ne nuk do të friksohemi dhe nuk do të shkojmë askund. Lëvizja jonë është e rrënjosur në qëndrueshmëri, në besimin se lufta për barazi dhe drejtësi nuk mund të kthehet pas.

"Asnjë Hap Mbrapa" është angazhimi ynë i palëkundur për të vazhduar përpara, pa marrë parasysh ndryshimet sociale ose politike që sfidojnë ekzistencën tonë. Do të luftojmë gjithmonë për të drejtat tona, për shoqëritë tona, dhe për përparimin tonë kolektiv që të mbetet i papenguar. Java e Krenarisë e këtij viti është një deklaratë e fuqishme që ne nuk do të dorëzohemi para atyre që kërkojnë të na marrin të drejtat që i kemi fituar me mund. Është thirrja jonë për veprim—të qëndrojmë së bashku, të mos kemi frikë, dhe të vazhdojmë të luftojmë për botën që na takon. Ne do të vazhdojmë të ngrihemi, të rezistojmë dhe të luftojmë për një shoqëri ku çdo njeri mund të jetojë i/e lirë dhe me dinjitet të plotë.

Vëmendje: Në fund të broshurës mund të gjeni informacion në lidhje me sigurinë tuaj gjatë kësaj jave dhe angazhimin tonë për Hapësira më të Sigurta. Nëse keni nevojë për informacion shtesë, kontaktoni një nga vullnetarët ose stafin e Javës së Krenarisë.

09 QERSHOR

Hapja Zyrtare e Javës së Krenarisë 2025

18:00 / Ndërtesa e Qeverisë

Hapja zyrtare e Javës së Krenarisë mbahet nën përkujdesjen e Zyrës për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit – Zyra e Kryeministrit.

Fjalim i Mirseardhjes nga:

Habit Hajredini

Zyra e Qeverisjes së Mirë

Fjalimet përshëndetëse nga:

Vjosa Osmani

Presidente e Republikës së Kosovës (TBC)

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Blert Morina

Drejtor Ekzekutiv, CEL Kosova

Ambassador Aivo Orav

Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë

Jonas Westerlund

Ambasador i Suedisë në Kosovë

**Ngjarja është e hapur për media.*



09 QERSHOR

"Let's Pride"

20:00 / Bubble Pub

Takimi i parë festues i Javës së Krenarisë është tradicionalisht i dashur dhe shumë i pritur çdo vit. Ku tjetër do ta ndajmë këtë dashuri, përveç në Bubble Pub, duke festuar njëri-tjetrin/njëra-tjetrën dhe përparimin që kemi bërë gjatë 9 viteve të fundit të Prishtina Pride!

Bashkohu me ne nga ora 20:00 dhe mbaj parasysh sloganin "Asnjë Hap Mbrapa" – hajde si vetja dhe shkëlqej në krejt ngjyrat e tua!

Muzikë nga:

Vesa Bunjaku dhe Jeta

Fjalimi i hapjes nga:

Rajmonda Sylbije

CSGD

**Ngjarja nuk është e hapur për media.*



10 QERSHOR

Punëtorja **"Art për Krenari"**

11:00 - 17:00 / Barabar Center

Një workshop për artistët/et queer për të krijuar dhe ndarë punën e tyre në një Ekspozitë të Hapur.

Një ftesë për të gjithë artistët/et që dëshirojnë të ndajnë një hapësirë me artistë/e të tjerë dhe të punojnë së bashku në krijimin e veprave të bazuara në sloganin tonë "Asnjë Hap Mbrapa" – si e perceptojnë ata/ato të qenurit queer në Kosovë dhe si rezonon ky slogan me ta.

Mentore:

Zana Ramadani

Artiste

**Ngjarja nuk është e hapur për media. Ngjarja është e hapur vetëm për aplikuesit/et e përzgjedhur/a përmes thirrjes së hapur.*



10 QERSHOR

Panel Diskutimi:

"Çfarë do të thotë të jesh queer në UP?"

11:00 / Activism HUB, Zyret e YIHR KS

Iniciuar nga Lëvizja Queer Studentore, ky panel diskutimi është mundësia jonë për të hapur një bisedë të thellë mbi përvojat dhe sfidat që hasin individët queer në Universitetin e Prishtinës. Bashkë me studentë/e, profesorë/e, alumni dhe aleatë/e, do të diskutojmë mbi hapësirat që ofron universiteti për komunitetin queer dhe barrierat që ende ekzistojnë për të krijuar një ambient të hapur dhe të mbështetur për të gjithë/a.

Në këtë ngjarje, do të dëgjojmë perspektiva nga studentë/e, alumni dhe pedagogë/e të cilët do të ndajnë përvojat e tyre personale dhe mendimet për përmirësimin e politikave universitare për t'i bërë ato më gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse për individët queer. Ky panel është një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në një debat të sinqertë dhe të respektueshëm.

Bashkohuni me ne për të thelluar bisedën dhe për të ndihmuar në krijimin e një universiteti më të hapur dhe më të drejtë për të gjithë/a!

Lëvizja Queer Studentore

**Ngjarja nuk është e hapur për media.*



10 QERSHOR

Hapja e Ekspozitës "Art për Krenari"

18:00 / Barabar Center

E hapur deri më 13.06 në ora 17:00

Hapja e Ekspozitës "Art për Krenari", duke paraqitur veprat e përfunduara të pjesëmarrësve/eve nga workshopi "Art për Krenari".

Kuratore:

Zana Ramadani

**Ngjarja është e hapur për media.*



10 QERSHOR

Ngjarje me Ambasadat dhe Mbështetësit/et

19:00 - 21:00

Në kuadër të Javës së Krenarisë 2025, kemi nderin të bashkohemi me ambasadat, aleatët/et dhe miqtë/mikeshat tanë/tona në një pritje (reception) shumë unike për të gjithë neve. Kjo mbrëmje është një dëshmi e fuqisë së lidhjes dhe forcës që ndërtojmë përmes mbështetjes së ndërsjellë dhe solidaritetit.

Fjalë mirëseardhëse:

Karin Boven

Ambasadorja e Mbretërisë së Holandës

Arbër Nuhui

Drejtor Ekzekutiv, CSGD

**Ngjarja nuk është e hapur për media. Vetëm me ftesa.*



11 QERSHOR

Masterclass: Dëmet Online

10:00 - 13:00 / Kino ARMATA

Bashkohuni me strategun e komunikimit dhe regjisorin e "Dare to be Grey", Jordy Nijenhuis, për një sesion interaktiv mbi luftimin e dezinformacionit, gjuhës së urrejtjes dhe polarizimit digjital.

Masterclass do të zhvillohet në Kino Armata, më 11 qershor, duke filluar nga ora 10:00 - 13:00.

**Ngjarja nuk është e hapur për media. Ngjarja është e hapur vetëm për aplikuesit/et e përzgjedhur/a përmes thirrjes së hapur.*



11 QERSHOR

Queer Brunch

15:00 - 21:00 / Rezidenca 17

Po mbledhemi në Rezidenca 17 për një ditë të mbushur me muzikë, vallëzim, ushqim, yoga dhe rretëzim. Duke filluar nga ora 15:00 me përzgjedhje muzikore, gjatë ditës pjesëmarrësit/et do të kenë mundësinë të njihen më shumë me disa nga OJQ-të organizuese të Javës së Krenarisë, shërbimet dhe mundësitë që ato ofrojnë. Nga ora 17:00 do të mbahet një klasë e hapur e Yogës, ndërsa nata do të përmbyllet me një performancë të mrekulueshme live nga grupi Mesnata.

Music:

Mesnata

Yoga:

17:00-18:00

OJQ-të pjesëmarrëse:

CEL Kosova, CSGD, QIPS

**Ngjarja nuk është e hapur për media.*



12 QERSHOR

Punëtori për Shkrim: "ASNJË HAP MBRAPA"

13:00 - 16:00 / Bubble Pub

Prishtina Pride 2025 fton të gjithë zërat queer! Bashkohuni me artisten dhe aktivisten Uresa Ahmeti për një punëtori shkrimi ku pasioni takohet me lapsin dhe letrën. Slogani i këtij viti është "ASNJË HAP MBRAPA", dhe në këtë punëtori do e shndërrojmë këtë mesazh në veprim.

Punëtoria është e hapur për të gjithë personat queer — nuk kërkohet përvojë shkrimi, vetëm pasioni dhe historia juaj. Përmes shkrimit kreativ, tregimit të historive dhe bisedave të sinqerta, do të eksplorojmë çfarë do të thotë të rezistosh, të dashurosh dhe të ecësh përpara pa frikë.

Prandaj, sillni zërin, energjinë dhe ëndrrat tuaja. Së bashku, do të krijojmë diçka të fuqishme. Asnjë hap mbrapa!

Mentore:

Uresa Ahmeti

**Ngjarja nuk është e hapur për media. Ngjarja është e hapur vetëm për aplikantët/et e përzgjedhur/a përmes thirrjes së hapur.*



12 QERSHOR

Pride Talk me Vullnet Krasniqin

19:00 - 20:00 / Barabar Center

Bashkohuni me ne për një bisedë intime e personale në kuadër të serisë së Pride Talks - kësaj here me Vullnet Krasniqin.

Vullneti, një gazetar i shquar LGBTQI+ dhe aktivist i zëshëm, do të ndajë rrugëtimin e tij personal në luftën për të drejtat e njeriut, veçanërisht në fushën e gazetarisë dhe medias, duke theksuar sfidat dhe fitoret kryesore. Kjo është një mundësi për të bashkëbiseduar, mësuar dhe për t'u frymëzuar!

**Ngjarja është e hapur për media.*



12 QERSHOR

Natë Poetike: "Veç Përpara"

20:00 - 22:00 / Bubble Pub

Kjo është një natë ku fjalët çlirohen, ku tregimet tona — të pathëna dhe pa kërkuar falje — vihen në qendër. Një festë e qëndresës, dashurisë dhe ndryshimit pozitiv përmes poezisë.

Pjesëmarrësit/et shkrimtarë/e nga punëtoria e shkrimit "Asnjë Hap Mbrapa" do të ndajnë krijimet e tyre origjinale, duke sjellë pasionin, autenticitetin dhe fuqinë e zërave queer.

Për më tepër, mos e humbni performancën e veçantë nga Uresa Ahmeti, e cila do të ndërthurë fjalën artistike dhe muzikën, duke i dhënë natës edhe më shumë ngjyra të fuqishme.

Qofsh poet me përvojë apo i/e re në mikrofoni, kjo hapësirë është për ty — për të thënë të vërtetën tënde. Asnjë Hap Mbrapa, Veç Përpara!

Host & Performuese:

Uresa Ahmeti

**Ngjarja nuk është e hapur për media.*



13 QERSHOR

Konferenca Vjetore:

Shteti dhe të Drejtat e Personave LGBTQI+
– Përgjegjësitë në Kohë Sfiduese

10:00 - 13:00 / Sirius Hotel

Fjalë mirëseardhjeje:

Rina Braimi

Drejtoresha e Programit, CEL Kosova

Paneli I:

Përgjegjësitë e Shtetit në Avancimin e të Drejtave të Personave LGBTQI+

Moderatore:

Marigona Shabiu

Drejtoresha Ekzekutive, YIHR KS

Panelistë/e:

Mr. Naim Qela

Avokat i Popullit

Rajmonda Sylbije

Drejtoresha e Programit, CSGD

**Përfaqësues/e nga
Ministria e Kulturës (TBC)**

Paneli II:

Sfidimi i Lëvizjeve Anti-Gjinore dhe Forcimi i Solidaritetit Global

Moderatore: Yllka Soba

Zyrtare e Programit,
Civil Rights Defenders

Panelistë/e:

Luljeta Demolli

Drejtoresha Ekzekutive,
Qendra Kosovare për
Studime Gjinore (QKSGJ)

Lura Limani

Udhëheqëse e Programit për
Integrim Evropian dhe Bashkëpunim
Rajonal, Fondacionet e Shqërisë së
Hapur – Ballkani

**Ngjarja është e hapur për media.*



13 QERSHOR

Drag Show: ASNJË TAKË MBRAPA

21:00 - 01:00 / Teatri ODA

A përmendi dikush performanca drag t'paharrushme?

Ju kemi dëtguju! Këtë vit po sjellim një përvojë ndryshe me disa mbretëresha drags që ndoshta i kishit harruar me emër, por ato janë këtu për t'ju kujtuar se nuk harrohen lehtë.

Honey, Seri Bazi, Rina, Queen Maggy dhe Diva do të sjellin performancat më të fuqishme të vitit në Teatrin ODA, të premtën me datë 13 qershor.

Bashkë me to, Arbër dhe Gent do të kujdesen për atmosferën para dhe pas performancave, duke mbajtur publikun në kulmin e energjisë.

Host:

Semi

DJs:

**Arbër
Gent**

**Ngjarja nuk është e hapur për media.*



14 QERSHOR

Parada e Krenarisë 2025

17:30 / Sheshi Skënderbeu

Pikëtakimi për Paradën e Krenarisë do të fillojë në orën 17:30 në Sheshin Skënderbeu. Në orën 18:00 do të nisë marshi i krenarisë përgjatë bulevardit dhe do të përfundojë te Biblioteka Kombëtare. Parada do të përmbyllet me koncertin tradicional!

Koncerti i Paradës së Krenarisë

19:00 - 23:00 / Biblioteka Kombëtare

Krenaria është protestë dhe festë. Pas paradës sonë, qëndresa vazhdon me koncertin vjetor të Paradës së Krenarisë. Përgatituni për dashuri, ritme fantastike dhe vallëzim të çmendur!

Muzikë nga: Moderator:

**Erleta
Rebiswan
Miranda**

Semi

**Ngjarja është e hapur për media.*



Masat e Sigurisë gjatë Paradës së Krenarisë

Pas përfundimit të Paradës së Krenarisë dhe koncertit, të gjithë pjesëmarrësit/et udhëzohen të largohen nga zona përkatëse. Udhëzohen të gjithë që t'i largojnë materialet që simbolizojnë personat LGBTIQ+ dhe Paradën e Krenarisë (flamujt, banerët dhe materialet e tjera promovuese).

Në rast se keni ndonjë pyetje, referojuni vullnetarëve/eve dhe/ose stafit.

Siguria e secilit/ës është shumë e rëndësishme për ne.

Numrat emergjent:

**192 - Policia e Kosovës
194 - Emergjencia**

ZOTIM PËR NJË HAPËSIRË MË TË SIGURTË

Respekto kufijtë.

Gjithmonë kërko pëlqimin përpara se të angazhohesh në kontakt fizik apo emocional. Respekto kufijtë e personit tjetër, duke i kushtuar vëmendje edhe sinjaleve joverbale.

Komunikoni aktivisht me njerëzit përreth jush.

Nëse nuk jeni të sigurt/a për diçka, bëni pyetje, dëgjoni me kujdes dhe sigurohuni që të mos ketë keqkuptime. Sigurohuni që personi tjetër të ndihet rehat, të jetë në moshë madhore, etj.

Vetëm një 'po' entuziaste dhe e qartë është po.

Nëse dikush refuzon ofertën ose kërkesën tuaj, respektoni vendimin e tyre pa ushtruar presion të mëtejshëm. Edhe nëse fillimisht thonë po, ata/ato mund ta ndryshojnë mendjen dhe të thonë jo në çdo moment. Situata të tjera që gjithashtu nuk konsiderohen pëlqim janë: kur personi tjetër është i heshtur, hezitues ose nën ndikimin e substancave që ndikojnë në gjykimin e tij/saj.

Nuk tolerojmë asnjë lloj seksizmi, homofobie, transfobie, racizmi, diskriminimi, turpërimi të trupit/aftësive apo mungese respekti të çfarëdo lloji.

Nëse keni ndonjë shqetësim gjatë eventit ose nëse dikush po ua prish përvojën, ju lutemi kontaktoni dikë nga ekipi i Javës së Krenarisë ose sigurimin/policinë.

Aktivitetet e Javës së Krenarisë kanë një listë të personave të cilët nuk lejohen të marrin pjesë në aktivitete.

ORGANIZED BY:



PARTNERS:



SUPPORTED BY:



Co-funded
by the European Union



COUNCIL OF EUROPE



Co-funded and implemented
by the Council of Europe

